



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Nr./Br. 04-633/24-7460/2

Rruga Tuz nr. 1, nr. 44
Ulica Tuzi br.1, br. 44
+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 04.11.2024. godine

KOMUNA E TUZIT
KOMISIONI PËR ZBATIMIN E THIRRJES PUBLIKE
PËR DHËNIEN E PERDORIMIT PA PAGESË
TË OBJEKTEVE TË MONTUESHME TË PËRKOHSHME
(SHTËPIZA/STENDA) PËR NEVOJAT
E ORGANIZIMIT TË PAZARIT TË DIMRIT

Komisioni për zbatimin e thirrjes publike për dhënie në përdorim pa pagesë të objekteve të montueshme të përkohshme (shtëpiza) për nevojat e organizimit të “Pazarit të Dimrit në Malësi” 2024-2025. (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i krijuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.01-633/24-7460/1 të datës 30.10.2024, shpall

THIRRJE PUBLIKE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA PAGESË TË
OBJEKTEVE TË MONTUESHME TË PËRKOHËSHME (SHTËPIZAT) PËR
NEVOJAT E ORGANIZIMIT TË PAZARIT TË DIMËRIT NË MALËSI
20 DHJETOR 2024 - 02 JANAR 2025
SHESHI I RI

Komuna e Tuzit organizon “Pazarin e V të Dimrit në Malësi”, i cili do të mbahet nga 20 dhjetori 2024 deri më 2 janar 2025.

Ftojmë të gjithë të interesuarit, sipërmarrësit, artizanët, kompanitë ekonomike nga territori i komunës së Tuzit, të cilet merren me veprimtari të ndryshme zejtarie-punë dore, bujqit me prodhime sezonale pije dhe prodhime ushqimore, si dhe personat e angazhuar në ofertën dhe prodhimin gastronomik, të aplikojnë për pjesëmarrje në Pazarin e V të Dimrit dhe të shfrytëzojnë falas shtëpizat gjatë periudhës së caktuar.

Komisioni i trajnuar do të vendosë kriteret për përzgjedhjen dhe përdorimin e shtëpizave. Aplikimet bëhen duke plotësuar formularin e aplikimit, i cili mund të dorëzohet nga data 7 nëtor deri më 21 nëntor 2024. deri në orën 16:00, në adresë elektronike tuzi@tuzi.org.me; me postë në adresën: Komuna e Tuzit, Tuzi bb ose direkt në arkivin e komunës së Tuzit, me shënim për pjesëmarrje në Pazarin e dimrit në Malësi.

KRYETARJA E KOMISIONIT,
Marina Ujkaj

